VENDIM
Nr.964, datë 24.11.2010

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 27.5.2010, PËR ÇËSHTJEN NR.847/05, "BERHANI KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 2.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 27.5.2010, për çështjen nr.847/05 "Berhani kundër Shqipërisë", në shumën 4 800 (katër mijë e tetëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave. Afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 4.1.2011.
3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
4. Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z.Gentian Berhani, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Gentian Berhani, të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha